

VENDIM
Nr.564, datë 14.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 2, DATË.9.1.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË
EMERGJENCAVE CIVILE NË QARKUN E SHKODRËS, PËR TË PËRBALLUAR
SITUATËN E SHKAKTUAR NGA PËRMBYTJET NATYRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 7 e 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190 datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a” e pikës 1 të vendimit nr.2, datë 9.1.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Shuma prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh nga fondi rezervë i buxhetit;”.

2. Rimbursimi i shpenzimeve të kryera nga fondi rezervë i buxhetit, të destinuara për fondin e emergjencave civile në qarkun e Shkodrës, do të mbulohet nga:

a) përdorimi i donacioneve monetare, të mbledhura në llogaritë bankare, të çelura për këtë qëllim;

b) fondet e mbetura të papërdorura në programin “Emergjencat civile”, të miratuara për vitin 2010, për Ministrinë e Brendshme.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha